

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 6

Kërkimet për Burime Minerare dhe Vlerësimi i tyre

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij SNRF-je është specifikimi i raportimit financiar të kërkimit dhe vlerësimi i burimeve minerare.
- 2 Në veçanti, SNRF-ja synon:
 - (a) përmirësime të kufizuara të praktikave ekzistuese kontabël për shpenzimet e kërkimit dhe vlerësimin e tyre.
 - (b) njësitë ekonomike që identifikojnë aktivet minerare të kërkuara dhe vlerësuar duhet të përcaktojnë zhvlerësimin e këtyre aktiveve sipas SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve.
 - (c) dhënia e informacioneve shpjeguese që identifikojnë dhe shpjegojnë shumat në pasqyrat financiare të njësive ekonomike, të cilat lindin nga kërkimi dhe vlerësimi i tyre i burimeve minerare, dhe i ndihmojnë përdoruesit e këtyre pasqyrave të kuptojnë shumat, vendosjen në kohë dhe sigurinë e fluksit të mjeteve monetare në të ardhmen nga çdo aktiv i njohur mineral.

Objekti

- 3 Një njësi ekonomike do të zbatojë SNRF-në për çdo shpenzim të bërë për kërkim dhe vlerësim.
- 4 SNRF-ja nuk i adresohet aspekteve të tjera të kontabilitetit të njësive ekonomike që merren me kërkimin dhe vlerësimin e burimeve minerare.
- 5 Njësia ekonomike nuk do ta zbatojë këtë SNRF për shpenzimet e bëra:
 - (a) përpara kërkimit dhe vlerësimit të tyre të burimeve minerare, si për shembull shpenzimeve të bëra përpara se njësia ekonomike të gëzojë të drejtën ligjore për kërkimin në një fushë të caktuar.
 - (b) pasi të demonstrohet aftësia teknike dhe qëndrueshmëria tregtare për nxjerrjen e burimit mineral.

Njohja e aktiveve të kërkimit dhe vlerësimi i tyre

Përjashtim i përkohshëm nga SNK 8 paragrafët 11 dhe 12

- 6 Njësia ekonomike, gjatë zhvillimit të politikave të veta kontabël të njohjes së aktiveve të kërkimit dhe vlerësimi i tyre do të zbatojë paragrafin 10 të SNK 8 Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.
- 7 Paragrafët 11 dhe 12 të SNK 8 specifikojnë burimet e kërkesave dhe udhëzimeve autoritare që duhet të shqyrtojnë drejtimin gjatë përpilimit të një politike kontabël për një zë, nëse asnjë SNRF nuk gjen zbatim specifikisht për atë zë. Në zbatim të paragrafëve 9 dhe 10 më poshtë, ky SNRF çliron njësienë ekonomike nga çdo përgjegjësi për zbatimin e këtyre paragrafëve tek politikat e veta kontabël të njohjes dhe matjes së aktiveve minerare.

Matja e aktiveve minerare

Matja dhe Njohja

- 8 Aktivet minerare do të maten me kosto.

Elementet e kostonë së aktiveve të kërkimit

- 9 Një njësi ekonomike e përcakton politikën e vet kontabël duke specifikuar se cilat shpenzime mund të njihen si aktive kërkimi dhe vlerësimi, duke e zbatuar në mënyrë të qëndrueshme këtë politikë. Në dhënie të këtij përcaktimi, një njësi ekonomike shqyrton deri në çfarë shkallë mund të lidhen shpenzimet me gjetjen

e burimeve minerare specifike. Më poshtë paraqiten shembuj të shpenzimeve që mund të përfshihen në matjen paraprake të aktiveve minerare të kërkuara dhe vlerësuara (lista nuk është e fundme):

- (a) marrja e të drejtës për kërkim;
 - (b) studimet topografike, gjeologjike, gjeo-kimike dhe gjeofizike;
 - (c) gjurmimet kërkuese;
 - (d) hapja e puseve;
 - (e) marrja e kampioneve; dhe
 - (f) aktivitetet që lidhen me vlerësimin e aftësisë teknike dhe qëndrueshmërisë tregtare të nxjerrjes së burimit mineral.
- 10 Shpenzimet që lidhen me zhvillimin e burimeve minerare nuk do të njihen si aktive kërkimi dhe vlerësimi. *Kuadri konceptual për raportimin financiar* dhe SNK 38 *Aktivitet afatgjatë jo materiale* japin udhëzime për njohjen e aktiveve që krijohen nga zhvillimi.
- 11 Në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara*, një njësi ekonomike njihet ndonjë detyrim që krijohet nga heqja dhe restaurimi që ndodh gjatë një periudhe të caktuar si pasojë e ndonjë kërkimi të ndërmarrë dhe vlerësimit të burimeve minerare.

Matja pas njohjes

- 12 Pas njohjes, një njësi ekonomike do të zbatojë tek aktivet minerare të kërkuara dhe vlerësuara të tyre, metodën e vlerësimit me kosto ose metodën e rivlerësimit të tyre. Në rast se zbatohet modeli i rivlerësimit të tyre (metoda e paraqitur tek SNK 16 *Toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje* ose tek SNK 38) duhet të jetë në përputhje me klasifikimin e aktiveve (shih paragrafin 15).

Ndryshimet në politikat kontabël

- 13 Një njësi ekonomike mund të dojë të ndryshojë politikat e veta kontabël të shpenzimeve të kërkimit të burimeve minerare në rast se ky ndryshim i bën pasqyrat financiare më të përshtatshme për nevojat e përdoruesve në marrjen e vendimeve ekonomike, dhe jo më pak, por më shumë të besueshme, për këto nevoja. Njësia ekonomike gjykon përkatësinë dhe besueshmërinë e tyre sipas kriterit të SNK 8.
- 14 Për të argumentuar ndryshimet në politikat kontabël të shpenzimeve për kërkim dhe vlerësim, njësia ekonomike do të demonstrojë se ndryshimi i sjell pasqyrat financiare më pranë përmbushjes së kriterëve të SNK 8. Nuk është nevoja që ndryshimi të arrijë një përmbushje të plotë të këtyre kriterëve.

Paraqitja

Klasifikimi i aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara

- 15 Në varësi të natyrës së aktiveve, një njësi ekonomike do t'i klasifikojë aktivet për kërkim dhe vlerësim si materiale dhe jo-materiale, dhe ta zbatojë në përputhje me këtë klasifikim.
- 16 Disa aktive kërkimi dhe vlerësimi trajtohen si jo-materiale (p.sh. të drejtat për gjurmim), ndërsa të tjerat si materiale (p.sh. mjetet motorike dhe pajisjet për gjurmim). Shuma që reflekton amortizimin është pjesë e kostonë së aktivitetit jo-material deri në pikën kur aktiviteti material konsumohet për krijimin e një aktiviteti jo-material. Megjithatë, përdorimi i një aktiviteti material për krijimin e një aktiviteti jo-material nuk e shndërron aktivitetin material në një aktivitet jo-material.

Riklasifikimi i aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara

- 17 Një aktiv kërkimi dhe vlerësimi i tyre nuk klasifikohet më si i tillë nëse janë të demonstrueshëm aftësia teknike dhe qëndrueshmëria tregtare. Para klasifikimit, aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara do të testohen për zhvlerësime, dhe çdo humbje e shkaktuar nga zhvlerësimi i tyre do të njihet.

Zhvlerësimi

Njohja dhe matja

- 18 Aktivët minerare të kërkuara dhe të vlerësuara do të vërehen për zhvlerësime nëse faktet dhe rrethanat sugjerojnë se vlera kontabël e një aktivi kërkimi dhe vlerësimi mund të tejkalojë shumën e rikuperueshme. Kur faktet dhe rrethanat sugjerojnë se vlera kontabël tejkalon shumën e rikuperueshme, një njësi ekonomike do të matë, prezantojë dhe japë informacione shpjeguese sipas SNK 36 për çdo humbje të shkaktuar nga zhvlerësimi i tyre, përveç rastit të përmendur në paragrafin 21 më poshtë.
- 19 Vetëm për qëllim të aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara, në vend të paragrafëve 8–17 të SNK 36 do të zbatohet paragrafi 20 i kësaj SNRF-je kur njihet mundësia e zhvlerësimit të një aktivi kërkimi dhe vlerësimi. Paragrafi 20 përdor termin ‘aktive’ por zbatohet në mënyrë të barasvlershme për të ndarë aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare.
- 20 Një apo më shumë nga faktet dhe rrethanat e mëposhtme tregon se një njësi ekonomike duhet të testojë nëse ka zhvlerësime tek aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara (lista nuk është e fundme):
- (a) ka mbaruar gjatë periudhës apo do të mbarojë në të ardhmen e afërt, dhe nuk pritet të rinovohet periudha gjatë të cilës njësia ekonomike ka të drejtën e kërimit në një fushë të caktuar.
 - (b) nuk janë buxhetuar apo planifikuar shpenzimet thelbësore për kërkim dhe vlerësim të mëtejshëm të burimeve minerare në fushat e caktuara.
 - (c) kërkimi dhe vlerësimi i burimeve minerare në një fushë të caktuar nuk kanë sjellë deklarinimin e sasive të burimeve materiale me qëndrueshmëri tregtare, dhe njësia ekonomike merr vendimin t’i ndërprisë këto aktivitete në këtë fushë.
 - (d) ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të treguar se, edhe pse zhvillimi në fushën specifike ka mundësi të vazhdojë, vlera kontabël e aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara mund të mos rikuperohet plotësisht nga zhvillimi i suksesshëm apo shitjet.

Në secilin prej këtyre rasteve, njësia ekonomike do të kryejë test zhvlerësimi në përputhje me SNK 36. Sipas SNK 36, çdo humbje ekonomike nga zhvlerësimi i tyre njihet si shpenzim.

Specifikimi i nivelit sipas të cilit bëhet vlerësimi për zhvlerësimet e aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara

- 21 Një njësi ekonomike e përcakton politikën kontabël për shpërndarjen e aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara në njësi ose grupe njësishe që gjenerojnë mjete monetare, me qëllim që të vërehet nëse këto aktive janë zhvlerësuar. Çdo njësi apo grup njësishe që gjeneron mjete monetare ku vendosen aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara minerare nuk do të jenë më të mëdha sesa segmenti i shfrytëzimit që përcaktohet në përputhje me SNRF 8 *Segmentet e shfrytëzimit*.
- 22 Niveli i përcaktuar nga njësia ekonomike për testimin nëse ka zhvlerësime në aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara mund të përmbajë një apo më shumë njësi që gjenerojnë mjete monetare.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 23 Një njësi ekonomike do japë informacionin që identifikon dhe shpjegon shumat e njohura në pasqyrat financiare, të cilat janë krijuar nga kërkimi dhe vlerësimi i burimeve minerare.
- 24 Për t’u përmbajtur paragrafit 23, një njësi ekonomike do të shpjegojë:
- (a) politikën e veta kontabël të shpenzimeve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara duke përfshirë njohjen e aktiveve minerare të kërkuara dhe të vlerësuara.
 - (b) shumën e aktivitetit, detyrimit, të ardhurave dhe shpenzimeve, flukset e mjeteve monetare të shfrytëzimit dhe të investimit që krijohen nga kërkimi dhe vlerësimi i burimeve minerare.
- 25 Një njësi ekonomike do t’i trajtojë aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara si një klasë e veçantë aktivesh dhe të bëjë dhënie të informacioneve shpjeguese të kërkuara nga SNK 16 ose SNK 38 në përputhje me mënyrën e klasifikimit të aktiveve.

Data e hyrjes në fuqi

- 26 Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë SNRF për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2006 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton SNRF-në për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2006, ajo do ta deklarojë këtë fakt.
- 26A *Ndryshimet në referencat për kuadrin konceptual në standardet e SNRF-ve*, të publikuara në vitin 2018, kanë ndryshuar paragrafin 10. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 janar 2020 e në vijim. Aplikimi më i hershëm lejohet nëse njëkohësisht një njësi ekonomike gjithashtu zbaton të gjitha ndryshimet e tjera të përfshira në *Ndryshimet në referencat për kuadrin konceptual në standardet e SNRF-ve*. Njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në SNRF 6 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*.¹ Megjithatë, nëse një njësi ekonomike përcakton se aplikimi retrospektiv do të ishte i pazbatueshëm ose do të kërkonte kosto dhe përpjekje të panevojshme, ajo do të zbatojë ndryshimin në SNRF 6 duke i'u referuar paragrafëve 23-28, 50-53 dhe 54F të SNK 8.
- 26B SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafin 6. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Periudhat kalimtare

- 27 Nëse një kërkesë e caktuar e paragrafit 18 sipas informacionit krahasues, që lidhet me periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2006 është e pazbatueshme, njësia ekonomike do ta deklarojë këtë fakt. SNK 8 jep shpjegimin e termit 'i pazbatueshëm'.

¹ Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

Shtojca A

Termet e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së

aktivet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara	Shpenzimet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara njohura si aktive në përputhje me politikat kontabël të njësive ekonomike.
shpenzimet minerare të kërkuara dhe të vlerësuara	Shpenzimet e njësive ekonomike lidhur me kërkimin dhe vlerësimin e burimeve minerare përpara se të jetë demonstruar aftësia teknike dhe qëndrueshmëria tregtare e nxjerrjes së burimit mineral.
kërkimi dhe vlerësimi i burimeve minerare	Kërkimi për burime minerare, ku përfshihen mineralet, nafta, gazi natyror dhe burime të ngjashme të pa-ripërtërishme pasi njësia ekonomike të gëzojë të drejtën ligjore për kërkim në një fushë të caktuar, si dhe përcaktimi i aftësisë teknike dhe qëndrueshmërisë tregtare të nxjerrjes së këtyre burimeve minerare.

